

ALMA PAPAMIHALI  
**KUR PYET HËNA**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA



ALMA PAPAMIHALI

*Kur pyet hëna*

*poezi*

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Anrila Spahija  
Korrektore letrare: Petrina Ago  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Gjergj Paluca

ISBN 978-9928-235-64-0

© Autorja

<http://almapapamihali.com>

<http://www.facebook.com/pages/AlmaPapamihali/116955515003875>

E-mail: [almapapamihali@gmail.com](mailto:almapapamihali@gmail.com)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)



*Nëse ti buzëqesh me mua,  
Asgjë nuk qëndron më gri...*



## RRUGA E DIELLIT

Ç'po fluturon verë e bekuar,  
Që si braktisje në shpirt të ther,  
Natyra e zhveshur duhet mbuluar,  
Pa të trokasin shirat në derë.

E diell' i urtë herët do flejë,  
Dhe trupi i natës do pëshpëritë,  
Tek pret t'i ulet hëna mbi prehër,  
Mos u trishto, verë prapë do vijë!

# REALITET

Mund të jetë një mashkull  
(dhe femër mund të jetë)  
në mend s'ndihet kungull,  
s'e njeh as veten vetë.

Çdo ditë që vjen krekoset,  
dhe mendja i rri "plot",  
pas vetes kush marroset?  
njeriu-bosh, idiot...



# KOHËN TA PIMË

Më iku koha, nga pas i rashë,  
Eja ta ndjekim të dy,  
“Erë fluturake” ëmbël i thashë,  
Pse hesht e më fshihesh në sy.

Turbull e djeshmja vrapoi mbi urë,  
Dhe në të nesërmen zgjuar rrimë,  
E derdhura kohë s’mbushet kurrë,  
Eja “me fund” ta pimë...

## KJOJETË...

Kjo jetë është e tëra veç një lutje,  
Një thirrje që nga sytë gjer në hënë,  
Një zjarr që rri ndezur veç me puthje,  
Një det me premtime që s'janë thënë.

Kjo jetë është një trup që rri zhveshur,  
Me shpirtin e palënë në harresë,  
Ku njeriu dashuron dhe i heshtur,  
Ndryshe dhe pa vdekur mund të vdesë.